

AUF në Evropën Lindore dhe Qëndrore hap thirrjen rajonale për shprehje interesi: **Konkursi Rajonal "Ideja ime e Biznesit" 2019.**

Duke patur si prioritet strategjik futjen në tregun e punës dhe zhvillimin e kulturës së sipërmarrjes për studentët e institucioneve anëtare në Evropën Qendrore dhe Lindore (ECO), AUF-ja ka hapur një konkurs për studentët frëngjishtfolës, të të gjitha niveleve universitare.

Qëllimet e konkursit rajonal "Ideja ime e Biznesit" janë:

- të sensibilizojë studentët në mënyrë që të konsiderojnë krijimin e një ndërmarrjeje si një mundësi të rëndësishme në jetën e tyre profesionale;
- të nxisë dhe të promovojë nismat sipërmarrëse;
- të sjellë ide për krijimin e një biznesi;
- të mbështesë krijimin e biznesit;
- të nxjerrë në pah dhe të shpërblejë projektet më të mira të krijimit të biznesit.

Konkursi është i hapur për të gjithë studentët frëngjishtfolës të universiteteve anëtare të AUF-së në Evropën Qendrore dhe Lindore, pavarësisht nga mosha, gjinia ose fusha e studimit.

Kandidatët duhet:

- të jenë të regjistruar rregullisht në një universitet anëtar të AUF në Evropën Qendrore dhe Lindore ([auf.org/les\\_membres/nos-membres/](http://www.auf.org/les_membres/nos-membres/) <[http://www.auf.org/les\\_membres/nos-membres/](http://www.auf.org/les_membres/nos-membres/)>) gjatë periudhës së konkursit (prill - nëntor 2019, vitet akademike 2018 - 2019 dhe 2019 - 2020);
- të jenë frëngjishtfolës (duke filluar nga niveli B1);
- të plotësojnë formularin e konkursit në platformën <https://formulaire.auf.org> (Concours régional « Mon idée d'affaires » 2019, Europe centrale et orientale).

Dokumentet e referencës:

Për të shkarkuar rregulloren dhe formularin e aplikimit, klikoni në linkun e mëposhtëm: <https://www.auf.org/europe-centrale-orientale/nouvelles/appels-a-candidatures/concours->

[regional-idee-daffaires-  
2019/?fbclid=IwAR2NGs1Qiue2VHVwtWXF9JTRdJxgfzz7Ah1x9A4eV8Ow5gxTkWGXZbBn  
2L8](https://www.facebook.com/regional-idee-daffaires-2019/?fbclid=IwAR2NGs1Qiue2VHVwtWXF9JTRdJxgfzz7Ah1x9A4eV8Ow5gxTkWGXZbBn2L8)

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve: 21 qershor 2019 në orën 17h (ora e Bukureshtit).

Kontakt: [stages-eco@auf.org](mailto:stages-eco@auf.org)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese!